

## ETNOGRAFIA E TË FOLURIT PËR LIDHJEN E FEJESËS NË TRADITËN SHQIPTARE: FORMULËSIMET, URIMET, PËRSHËNDETJET

### **Abstrakt**

Etnografia e të folurit është një këndvështrim interesant i shprehjeve, të paraqitura si standard gjuhësor, me ngarkesë domethënëse emocionale linguistike, të përdorura në momente të caktuara, përfshirë edhe jetën rituale. Ajo shqyrton e hulumton në aspektin sociolinguistik shprehje e mënyra të thëni, të cilat kanë një bosht të caktuar etnografik dhe paraqesin interes për larminë e variacioneve gjuhësore të shpalosura tradicionalisht në këto ceremoni. Këtë synon edhe materiali i paraqitur në këtë studim lidhur me etnografinë e të folurit në traditën gojore shqiptare gjatë lidhjes së fejesës, duke u përqendruar në fjalët e urta, urimet, përshëndetjet, formulësimet e gatshme, të kthyer në rutinë zakonore dhe domosdoshmëri të natyrshme shoqëruese. Studimi ndalet edhe në ciklin e këngëve të fejesës, të cilat aplikohen të lidhura ngushtë me zakonet që kanë të bëjnë me momentin e dhënies së fjalës, me shenjat e fejesës, me mënyrat e njohura të të shprehurit në ceremoninë përkatëse dhe dhuratat e bëra me këtë rast.

**Fjalë kyçe:** etnografi e të folurit, këngë, shprehje, ceremoni

### **Abstrakt**

Speech ethnography is an interesting view of expressions, presented as a linguistic standard, with significant emotional linguistic loads, used at certain moments, including ritual life. It studies, in terms of sociolinguistics, expressions and ways of saying, which have a certain ethnographic axis and represent an interest in the variety of linguistic variations traditionally disclosed in these ceremonies. This is also aimed at the material presented in this study

regarding the ethnography of speech in the Albanian oral tradition during engagement, focusing on proverbs, congratulations, greetings, ready-made formulas, returned to the customary routine and the natural accompanying necessity. The study also stops in the engagement song cycle, which is closely related to the customs associated with the word giving, the engagement marks, the well-known ways of expressing at the ceremony and the gifts made to it case.

**Keywords:** ethnography of speech, song, expression, ceremony

Psikologjia mbizotëruese, objektivat për t'u arritur, parapëlqimet e dëshiruara nga bashkësia tradicionale shqiptare mbi lidhjen martesore, kanë gjetur pasqyrim në sjellje e komunikim të palëve dhe të individëve me njëri-tjetrin në të gjithë organizimin e ceremonialit, në domethënien kuptimore të secilës etapë, të secilit event. Njëherësh, botëvështrimi dhe konceptet mbi lidhjen bashkëshortore kanë reflektuar edhe në krijimtarinë folklorike dhe në atë që quhet *etnografia e të folurit*. Gjithnjë e më tepër, në kuadrin e zhvillimeve të shumta kulturore, ekonomike, politike, sociale, vërehet të jenë objekt marrëdhëniet gjuhë-shoqëri, gjuhë-mendësi, gjuhë-etni dhe ndikimet e këtyre raporteve nga faktorët jashtëgjuhësorë në zhvillimet ligjërimore, me gojë e me shkrim. Në këtë këndvështrim ka nisur të përdoret shpesh termi "etnografi e të folurit" (Shkurtaaj 2010). Është një pikëvërtetim mjaft interesant i disa shprehjeve, të paraqitura shpesh si standard gjuhësor, me ngarkesë domethënëse emocionale linguistike, të përdorura në momente të caktuara, posaçërisht në jetën rituale, të ritualeve familjare (lindje, martesë, vdekje), por jo vetëm. Për këtë arsye, janë bërë studime që shqyrtojnë e hulumtojnë në boshtin sociolinguistik shprehje e mënyra të thëni, të cilat kanë një bosht të caktuar etnografik dhe paraqesin interes për larminë e variacioneve gjuhësore të shpalosura ndër kohëra në këto ceremoni. Ky këndvështrim kërkon të nënvizojë bashkëveprimin e gjuhës së shprehur në raport me shoqërinë, psikologjinë shoqërore dhe me mënyrën e jetesës në përgjithësi. Këtë synon edhe materiali i paraqitur në këtë studim lidhur me etnografinë e të folurit në traditën gojore shqiptare për lidhjen e fejesës, si një fillim i mbarë i lidhjes martesore. Ai kërkohet të vendoset si studim i të shprehurit në kontekst etnologjik të mendimit, veprimit të dasmës tradicionale, në të cilën në të gjitha fazat gjenden fjalë të urta, urime, përshëndetje, formulësime të gatshme, të kthyer në rutinë zakonore dhe domosdoshmëri të natyrshme shoqërore.

Cikli i këngëve të fejesës lidhet me zakonet që kanë të bëjnë me momentin e dhënies së fjalës për lidhjen e krushqisë, me shenjat e fejesës, të cilat nënkuptojnë ceremoninë përkatëse dhe dhuratat e bëra me këtë rast. Sipas ligjeve të shtetit, nën të cilin kanë qenë shtetasit shqiptarë (deri në 1912 nën Perandorinë Osmane e më pas në shtetin shqiptar) jeta sociale e familjes, specifikisht martesë, ishte e rregulluar me ligj. Por, në vetëdijen sociale të shqiptarëve, prerja e fjalës për fejesë në aspektin familjar dhe shkëmbimi i nishaneve, ishin një angazhim aq publik, sa njerëzit e konsideronin ekuivalent me lidhjen ligjore të çiftit. (Dibra 2004). Për pasojë, ishte i përpunuar edhe një fjalor i posaçëm i formësuar ndër kohëra, i shfaqur dhe i përdorur në formula përcaktuese të përfundimit të punës, të konstituimit të lidhjes martesore, të tipit: *e premë fjalën, e ndame fjalën, e dha fjalën, u lidh fejesa, u këput puna, u dha vajza, u xu vajza, kemi nxënë nuse, po japim çikë, u dha dora e vajzës, u dha fjalënuja*. Janë shprehje formulësuese, të cilat kuptohen plotësisht në kontekst aplikativ, në përshkrim të saktë etnologjik. Nga ana tjetër, ky përshkrim etnologjik është i domosdoshëm për të kuptuar shprehshmërinë emocionale të hapave që ndiqeshin dhe gjithçkaje që ndodhte, kuptohej apo nënkuptohej gjatë ceremonisë së fejesës në traditën tonë.

Kryerja e këtij punimi është mbështetur në studimet dhe përmbledhjet e botuara që nga Rilindja e këndeje, në njohjen konkrete, në kujtesën e individëve të moshuar dhe në materialin arkivor të ruajtur në arkivat e IAKSA-së deri në gjysmën e shekullit XX, kohë kur ndër shqiptarë praktikohej akoma rituali kompleks, i gjatë dhe ceremonial i martesës. Sigurisht, ekzistojnë kufizimet që sjell pamundësia për të shkuar me dokumente të shumta folklorike konkrete para shekullit XIX. Megjithatë, edhe pse të përqendruar në një afat kohor jo aq të gjatë, përsëri doli natyrshëm e nevojshme që gjithë procedura e ndjekur, me gjithçka shoqëruese, të shihej në proces evolutiv nga koha në kohë, duke pasur parasysh se kemi të bëjmë me një periudhë kur shoqëria shqiptare dhe historia e saj kanë pësuar ndryshime të mëdha zhvillimore. Bazuar në këto materiale, kërkuam të vërejmë ngjashmëritë dhe diferencat nga krahina në krahinë, nga fusha në mal, në fshat apo qytet, nëpër komunitetet fetare të ndryshme, në komunitetet shqiptare brenda kufijve shtetërorë dhe jashtë tyre.

Thënë që në fillim, ajo që do të arrihet përmes analizës përgjatë gjithë shtjellimit, është se këto shprehshmëri komunikative gojore janë shumë të

ngjashme në aspektin kuptimor dhe tekstori ndër të gjitha krahinat, në Shqipëri dhe jashtë saj ku jetojnë shqiptarët, në shtetin e Kosovës, tek shqiptarët në Mal të Zi, Maqedoni, etj.

Na duket me shumë rëndësi të paraprijmë me një konkluzion në të cilin do të arrihet hap pas hapi. Përshëndetjet, urimet, formulësimet tradicionale në një ceremonial dasme janë shprehje të kopsitura mirë, tepër lakonike, ku fjala uruese rrjedh si një lumë i gjerë, i kthjellët, i qartë e domethënës. Ato janë shumë të gjetura për momentin ritualistik në të cilin përdoren, nganjëherë të paraqitura me fjalë që rimojnë ose shfaqen të shprehura si distikë të bukur, të detyrueshëm për t'u përdorur në kohën e duhur, të shërbyeshme si çelës për t'i vënë vulën e kërkuar ngjarjes rituale që ndodh. Janë shprehje koncize, të shpejta e të bukura dhe, edhe pse të përsëritura vazhdimisht, kanë shërbyer për të goditur në mendje dhe në zemër të personazheve të interesuar direkt, nuses dhe dhëndrit, të parëve të fisit, prindërve të tyre, motrave dhe vëllezërve dhe gjithë pjesëmarrësve, të gjithë atyre që ua ka kërkuar vendi të jenë të pranishëm në këto ceremoni. Aq më tepër, duhet të nënvizojmë se ka një numër shumë të madh shprehjesh në trajtën e fjalëve të urta, të cilat janë pjesë e ligjëritimit në ritual, por edhe jashtë tij, kur e kërkon nevoja për komunikim.

Në të gjitha rastet e bëra objekt studimi e vëzhgimi, dallohet qartë se gjatë ritualit martesor ka një protokoll të detyrueshëm për t'u zbatuar, të njohur nga të gjithë. Fillohet me vendimmarrjen e me të gjithë hapat vijues, duke mos u larguar vëmendja edhe në dukuritë më të thjeshta. P.sh., në çdo etapë të fejesës e martesës secili ulet në vendin ku i takon dhe nëse nuk zbatohet kjo ka pasoja për shumë kënd; i zoti i shtëpisë uron mirëseardhjen me shprehjet standarde dhe pastaj janë përshëndetjet formulësuere të rastit prej të tjerëve që do të shqyrtohen në vijim. Për një fejesë është tepër e rëndësishme *fjala e dhënë*, mbasi çështja të jetë peshuar mirë. Është një marrëveshje që në traditën tonë është bazuar te *fjala*, e cila ka pasur shumë më tepër peshë se sa nënshkrimi martesor në një formular shtetëror. Ndaj, ka formula të sakta që i vënë vulën kryerjes së një fejese dhe kanë forcën e një kodi ligjor të respektueshëm, si bie fjala, shprehja: "Ta kam falë vajzën."

Ndërsa, në rast mospranimi janë përsëri dy-tri fjalë të sakta me të cilat zhbëhet shpresa e kërkuar: "Të faleminderit, por nuk kam vajzë për të dhënë."

Materiali folklorik i vënë në qendër të kësaj analize dëshmon se kemi të bëjmë me një pjesë të shprehshmërisë gojore e cila, në sajë të lakonizmit, zhdërvjelltësisë interpretative, trajtave formulësuese, qëllimit për të cilin është krijuar, nuk mbeten kurrësi një komunikim i gjetur bukur, argëtim fjalësor prekës, por janë saktësisht kode shprehëse me vlera vendimmarrëse dhe me fuqi të plotë prapavepruese, që paraqesin edhe kërkesë të madhe për të folur sa më bukur e sa më qartë.

Në këngët rituale dhe në formulësimet shoqëruese të të gjitha etapave të dasmës, përgjithësisht i bëhet jehonë moralit mbështetës popullor, nevojës dhe dëshirës për të gjetur nga ana e baballarëve një fat sa më të mirë për bijtë, me parimin “fati i parë e ylli në ballë”; “njeriu një herë martohet dhe një herë vdes”; siç është në përforsim të së parës shprehja: “Burri i ve apo grua e ve nuk martohen me daulte”.

Në përgjigje të vendit që zë lidhja martesore ndër shqiptarë dhe në rajon, në përgjithësi nënvizojmë se urimin për një fat të mbarë e gjejmë që në reflektimin emocional në këngët e djepit. Ishte “fati” (lidhja bashkëshortore) i bardhë, i mbarë, i madh, që do t’i hapte e do t’i shtronte rrugët e jetës, do t’i bënte të lumtur fëmijët:

“Nana t’rrittë, baba t’fejoftë,/ Nanës qefi ju plotëssoftë,/ T’dyve zemrat Zoti jau gzoftë!” dhe “Vajza e nanës, fati t’priftë,/ Krejt Malsia ty të lypt!” (Brisku 2012, 173).

“Fli, moj bi, të pastë nana,/ Se t’martoj nër kapidana,/ T’i nap petkat palë e palë,/ T’përcjell nana n’kalë me shalë.” (*Lirika Popullore* 4, 1990, 506)

“Nani – nani, djalënë,/ Zëre gjumë e rrite shumë,/ Të ligat ja hedh në lumë,/ Që të rritet, ta martojmë,/ Me një nuse ta gëzojmë.” (*Lirika Popullore* 4, 1990, 530)

E njëjta psikologji dallohet në vendet e tjera të rajonit dhe shumë më gjerë. (Çapaliku, Rama, Dibra 2006, 78)

Urime për martesë të mbara gjejmë për të rinjtë edhe në fazën e tyre paramartesore. P.sh.: “Rafsh n’nafakë të hajrit!”; T’daltë nafaka e hajrit!; Ishalla t’pëlqen ikballi!” (Çetta 1980, 3) Urime të tilla, të referuara vetëm ndaj fatit martesor, si sjellës i lumturisë themelore gjatë gjithë jetës, kryesisht kanë lidhje

me karakterin e jetës, organizimin e saj, posaçërisht me rëndësinë parësore që ka pasur lidhja familjare, e përjetshme, e ndërlikuar, influencuese në mbarëvajtjen e njerëzve, funksione që ndërmjet të tjerave vijon t'i ketë lidhja e qëndrueshme edhe sot.

Ndër shqiptarë ishte më parësore dhe më e rëndësishme zënia e një miku të mirë se sa vetë vajza me të cilën do të martohet, pasi siç thoshin të vjetrit: “Bija e oxhakut dhe e burrit të mirë o djalin, o fjalën e mirë ta len në konak”; “Kam kqyrë me gjetun mik e jo vajzë”. (Berisha 2013, 55) Pra, nuk kërkohej shtëpi me pasuri (jo se përjashtohej kjo), por kërkohej shtëpi e mirë, që kishte të bënte me një koncept shumë më të gjerë se sa të qenit thjesht shtëpi e kamur. “Midis fiseve malësore kam parë zakone të kohëve të lashta. Zotërit e shtëpisë kishin kujdes që vajzat t'i martonin në vende të mira dhe për djemtë e tyre të siguronin gra nga dymet të nderuara” (Durham 1998, 238-239).

Edhe projektimi emocional në njësi të ndryshme folklorike e fiksonte kërkesën e lidhjes me oxhakun e dukur. Thuhet shpesh fjala e urtë: “Dru lisi e grue fisi”, ose këndohet: “M'u dogj zëmëra dhe barku/ për një vajzë bij'oxhaku...”

Duke lidhur fëmijët, krahas synimit për të ardhmen e tyre, prindi gjente mik për vete, për të zgjeruar rrethin, për të zgjidhur më lehtë çdo problem që i paraqitej për të mbrojtur pozitat e familjes në vazhdimësi. “Fejesa konsiderohej si një faktor edhe për forcimin ekonomik edhe shoqëror të familjeve respektive.”<sup>1</sup> “Krushqia lidhej ndërmjet familjeve të së njëjtës klasë apo rang social.”<sup>2</sup>

Duke iu referuar gjetjeve në terren, studiuesi Ramadan Sokoli përshkruan në dokumente arkivore se çfarë kërkohej kur nisej të zihej nusja për djalin.<sup>3</sup> Ai shkruan:

“në Mirditë, në Malësi të Madhe e në përgjithësi në zonën veriore shpija e djalit ...kërkon me ditë, posë fisit të saj edhe ku asht mesë e stërmesë. Lakmohet sidomos që të jetë shpi “pushkë e bukë”, si në

<sup>1</sup> IAKSA, Arkivi i Folklorit, Fondi: Fatbardha Reka, Dosja: 5, 284/9, Viti: 1964, Fl: 1.

<sup>2</sup> Po aty.

<sup>3</sup> Fjala “fejesë” nuk përdoret në të shkruarën, sipas krahinave kjo fazë e ritualit të dasmës emërtohej *zënie*, *mblesë*, *mbulesë*, *vlesë* etj. (sipas Dojaka 1983, 40)

cang ku ka le, si edhe kah dajat. Bahen hetime në mos u shkon për soj ndo'i sëmundje, nëse bëlbëzon ase nëse ka ndoj tjetër gand. Hulumtohen hollë tatë-gjyshet për ndo'i lidhje gjakut, gjinijet, kumbarijet e probatinijet, sado të largët ndërmjet sish, porse kanuni ua pengon krushqinë ndër këto rasa e vetë fisi kishte me i ndëshkue rrebtë.”<sup>4</sup>

Edhe në malësitë e Gjakovës kërkonin soji-sojin, gjë që sanksionohej edhe në fjalët e urta: “Katërdhetë vjet përpara i ngjet miku mikut”; “Soji sojit i ngjet shtatë faqe”; “Nuk merrej vajza e të pasojshmit sepse po t’i marrësh lulen ferrës, ajo të mbin në votër.” (Memia 1962, 278) Në përshkruesit dhe njohësit e terrenit nënvizohet se vihej shumë re gjaku i përbashkët, sepse shqiptarët i kanë krijuar lidhjet martesore nëpërmjet ekzogamisë, pra lidhja bëhej jashtë fisit.<sup>5</sup> Nuk martoheshin edhe sikur shumë e shumë breza të ishin larg. Kurse, nga ana e nënës, gjaku i përbashkët nuk vihej re dhe aq.<sup>6</sup>

Është e rëndësishme të theksohet se kjo mendësi përjashtuese ka pasur arsyet e veta të funksionimit në kohë dhe në hapësirë. Mbi të gjitha se ekzogamia si tabu krijonte qetësi sociale dhe lidhje sociale të sigurt. (Bardhoshi 2015, 358)

Kur zgjidhej nusja bëhej shumë kujdes të shikohej dhe të hetohej për nënën e saj. Fjalët e urta popullore: “Pëlhurës shikoi anën e vajzës shikoi nanën”; “Kqire mostrën e merr bezen, kqyre nanën e merr vajzën” (Halili 2012, 34); si dhe “Nanë e bi arkë e dri [y]” (po aty, 51) kanë qenë të ngulitura thellë në psikologjinë e shqiptarëve.<sup>7</sup>

Brenda kornizave të kësaj shoqërie ushtrohej pushteti absolut i prindit ndaj fëmijës. Kjo i detyrohej edhe pozitës që zinin fëmijët në ekonominë e shtëpisë. Këtë traditë dominuese trajtojnë dhe vargjet e këngës së mëposhtme:

<sup>4</sup> IAKSA, Arkivi Etnografik, Fondi: Ramadan Sokoli, Dosja: 14/6, Viti: 1950, Fl: 38.

<sup>5</sup> IAKSA, Arkivi Etnografik, Fondi: Afërdita Onuzi, Dosja: 28, 593/29, Viti: 1971, Fl: 13.

<sup>6</sup> Mbledhjet janë të viteve '60 të shekullit XX. IAKSA, Arkivi Etnografik, Fondi: Musa Muho, Dosja: 15.68, 429/16, Viti: 1967, Fleta: 65. Fondi: Vasil Xhaçka, Dosja: 43, Viti: 1963, Fl: 2.

<sup>7</sup> IAKSA, Arkivi Etnografik, Fondi: Musa Muho, Dosja: 15, 429/16, Viti: 1967, Fl: 74.

“Ene mor Hasan, djalë e more djalë/ A e kije mendjen , ti, nuse me marrë?/ Unë menen e kam, he po çish se kam,/ Jam to përgjue babën pale gjit po ban./ Ene, hoj ki baba rrin n’krye t’oxhakit,/ Le t’i çesë lirat more prej dukatit.”<sup>8</sup>

Në traditën patriarkale shqiptare, martesë, duke qenë tepër e rëndësishme, ishte pa dyshim çështje burrash; kishte nevojë për vulën e të zotit të shtëpisë dhe kodifikohej vetëm nga fjala e dhënë e tyre. Në shoqërinë shqiptare zakonet e vjetra patriarkale ishin skllavëruese për gruan. Femra nuk pyetej fare për zgjedhjen e së ardhmes së saj (Tirta 2003, 272).

Për vajzën martesë ishte sprovë e vështirë, që, sipas Kanunit, do të thoshte:

“...me lanë vajzninë e me u ba grue, do të thotë me vu “rrethin e hekurt kresë”, me humb një pjesë të lirisë, me iu ba petkë burrit e me iu përshtat njerëzve të tij.” (Martini 1998, 257)

Kur kërkohej për fejesë ndonjë vajzë, “hetohej” e kaluara e saj, e prindërve të saj si edhe ajo e farefisit. Paragrafi 31 i Kanunit thoshte se vajza s’ka tagër:

“a. me zgjedhë fatin e vet;

b. m’u përzi në shkusi as në fejesë;

c. as në këpucë as në petka.”<sup>9</sup>

Në kuadrin e formimit të karakterit të gjithanshëm pozitiv të vajzës vinte urimi: “Të daltë duvaku i bardhë!” (Çetta 1980, 4). Siç vërehet, e folura simbolike, edhe në formulësime, ka qenë karakteristikë e shprehshmërisë gojore dhe linte shteg për interpretime të shumta, të lidhura me pastërtinë morale të figurës së saj.

Asnjëherë nuk dërgohej shkes për t’i gjetur burrë vajzës. Ajo kërkohej për nuse:

<sup>8</sup> Zelaj. K. 1958. Arkiva personale. Sipas Halili 2012, 43.

<sup>9</sup> IAKSA, Arkivi Etnografik, Fondi: Afërdita Onuzi, Dosja: 28, 593/29, Viti: 1971, Fl: 13.

“Ka ardhë shkuesi me t’kërkue,/ Baba shkuesit i ka thane:/ -Cuca asht e volë për me u dhanë.-/ Në derë cuca ka nigjue,/ Nanës vet i paska thane:/ -Jam tamam, për me u dhanë.-/ Baba shkuesit i ka thanë:/ -Unë cucën ta kam dhanë.-”<sup>10</sup>

Nënvizuar në fillim të këtij studimi se fejesa dhe, në vijimësi të gjitha etapat e ritualit martesor, kanë pasur një etnografi të të folurit, standarde e të përcaktuar mirë për ritualin. Në kodifikimin e jetës në Shqipërinë tradicionale, etnografia e të folurit në këtë ngjarje bëhej shprehëse e mënyrës së të menduarit dhe shfaqej si pasojë edhe në fjalorin përkatës, sipas fazave të fejesës, madje shoqëruar edhe me gjuhën e gjesteve dhe reflektimin artistik emocional.

Për të përshkruar sa të jetë e mundur më saktë etnografinë e të folurit në një fejesë po ndjekim stadet e ritualit, që nga inicimi i lidhjes. Për këtë, i referohemi klasifikimit të bërë nga specialistët për këngët e ritualit martesor në botimin përkatës. (Velianj et al. 2010, 71)

Ideali estetik i shprehur në krijimtarinë gojore, siç e nënvizuar më sipër, ishte: një fejesë, një fat, një vdekje. Prindërit, për të justifikuar çdo pasojë të lidhjeve që organizonin, ia linin zgjedhjen një fuqie të mbinatyrshme, ndonëse të gjithë hapat i ndërmerrenin vetë. Ngado rezulton se shfrytëzohej në çdo rast shprehja justifikuese: Lindja, fejesa dhe vdekja janë të caktuara nga Zoti. Pra, këto veprime i shkruante vetë Zoti, njerëzve u mbetej vetëm të zbatonin vullnetin e të plotfuqishmit.

Ekziston në shqip fjalori emërtues i ngjarjes. Hapat që inicoheshin nga shtëpia e djalit në krahina të ndryshme kishin emërtimin e qartë të veprimit: “me zanë nusen”, “me feju djalin”, “me zanë rob”; “kam ardhur të ta kërkoj vajzën për djalin”, “të zënë në grua”.<sup>11</sup>

Zgjedhja e nuses përcaktohej në shprehje të tilla si: “Jemi tuj kqyr’ për ni rob të hajrit,” (Çoçaj 2012, 175) “Po kërkojmë një vajzë konaku” etj.

<sup>10</sup> IAKSA, Arkivi Etnografik, Fondi: Zelaj. K, Dosja: 52. Viti: 1958, Fl: 3.

<sup>11</sup> IAKSA, Arkivi Etnografik, Fondi: Musa Muho, Dosja: 15.73, Viti: 1967, Fl: 30.

Veprimet që nënkuptojnë këto shprehje përfaqësojnë hapat që ndërmerre prindi, me ndërmjetësimin e mësimit, shkuesit, sepse, siç nënvizuam, babai kishte fuqinë e plotë të vetvendosjes për jetën e fëmijëve të vet.

Sapo bëheshin marrëveshjet e përcaktuara dhe sanksionohej përfundimisht fejesa, dy të rinjtë menjëherë quheshin, sipas krahinave të ndryshme: *të zanë, n'xanë, nër unazë*. Vajza quhej *e zënë, e n'xanë, e zanë, e vluar, e mbuluar, e dhanme*; ndërsa djali quhej *i zënë, i n'xanë, i zanë, i vluar*. Veprimi emërtohej *zënie, lidhje*: “E lidhëm fejesën”; “I zumë nuse çunit”; “E zumë vajzën”;<sup>12</sup> “Dorë nusja” (Çoçaj 2012, 173) Është shumë interesant të nënvizojmë se sa delikatesë paraqet në vetvete emërtimi i fundit, duket sikur vajza vendos nëse do ta japë dorën e saj apo jo, kur realisht për fatin e saj vendosnin të mëdhenjtë e shtëpisë.

Ka fjalë të urta, të ngjashme në të katër anët e vendit që vlerësojnë fort lidhjen e krushqive, si garanci për fisin dhe si mbështetje e sigurtë, sepse “përzihej” gjaku nëpërmjet fëmijëve që vinin si pasojë e martesës dhe lidhja ishte e karakterit organizativ social, por edhe emocional. Janë të njohura dhe shumë të përhapura shprehje të tilla si: “Miku i mirë është krah i djathtë.” “Miku mikut i gan katërdhetë vjet përpara.” “Shtëpisë që i ke marrë çiken i ke marrë edhe meshkujt.”

Një cikël më vete në këngët e dasmës është ai kushtuar shkuesit, mblesit. Për këtë është shkruar në disa studime etnofolklorike të autorëve Llambrini Mitrushi, Miaser Dibra, Nebi Bardhoshi për dasmat në Myzeqe, Shkodër, për antropologjinë e kanunit. Ajo që i bashkon pohimet e bëra ndër këta studime, është detyra dhe rendi që ndiqej për ta zhvilluar ky njeri misionin e ngarkuar, mënyra se si i jepej e se si ai e kryente porosinë, koordinimi i fjalëve me veprimet, pra lidhja e gjuhës së artikuluar me fjalë, me gjuhën e gjesteve që bashkëlidhej me vendosmërinë për t’ia arritur qëllimit.

Në shtëpinë e djalit shkuesi, që zakonisht ishte mik (më mirë akoma të ishte mik i të dy shtëpive), pra përgjithësisht kishte njohje prej andej nga nisej dhe aty ku shkonte, urohej shumë për mbarësi tek përcillej për të kryer misionin e tij. Këtë kuptim parësor kanë formulësimet dhe urimet që i jepeshin atij kur nisej për të kryer detyrën e ngarkuar.

<sup>12</sup> IAKSA, Arkivi Etnografik, Fondi: Vasil Xhaçka, Dosja: 43, Viti: 1963, Fl: 4.

Formulësimet dhe urimet paraprake janë që puna të shkonte mbarë. Përgjithësisht urohej pak a shumë kështu: “Me këmbë të mbarë! Të fala e t’mira paç!” Shkuesi përgjigjej: “Faqja e bardhë, hajt, gëzuar, mor mik!”

Nënvizojmë se në thelb kërkohet që krushqia duhet të ishte e qëruar, e qartë, e nderhme sepse ishte për të gjatë mot, kërkohet të ruhej faqja e bardhë, erzi, nderi, të mos përlyheshin për asnjë arsye. (Mitrushi 1972, 181)

Nga shumë përshkrime të ngjarjes së ndodhur në terren rezulton se shkuesi hynte në bisedime me të parin e shtëpisë së vajzës, duke e bërë me dije shkaku të vizitës, së pari, me gjuhën e gjesteve. Duhet nënvizuar se, etnografia e të folurit bashkëshoqërohet edhe me gjeste karakteristike. Shkaku i vizitës së tij ishte shumë i deshifrueshëm, thuhet në të gjithë vendin. Shkuesi i drejtohet zjarrit, kur shkonte në shtëpinë e vajzës për ta kërkuar. Afrimi te zjarri, marrja në dorë e mashës dhe shpupurishja e tij zakonisht ishin veprime që donin të thoshin se pritej një kërkesë shkuesie nga ana e këtij njeriu.<sup>13</sup>

Etnografja Afërdita Onuzi sjell këtë panoramë për ditën kur shkuesi shkonte për të kërkuar së pari vajzën për fejesë në Lumë:

“Kur arrinte në shtëpinë e vajzës, ku zakonisht ishte njeri i njohur, shpesh mik, kuptohej se ka shkuar për propozim fejese nëse duke ndenjur shpupuriste zjarrin me mashë. Kjo do të thoshte se tani duhet dëgjuar përse ka ardhur”.<sup>14</sup>

Të njëjtën gjë nënvizon edhe Ramadan Sokoli nga vëzhgimet e terrenit për këtë mision të shkuesit në ditën e parë. Ai thotë se në Mirditë

“orvaten me gjetë për shkues një mik a dashamir të shpisë së vajzës... Kur ky shkon së parit në shpi të vajzës për shkuesi, i hudhet zjarrit dhe e shpupurishë me mashë. –Ç’ka ke more?– e pyesin ata të shpisë. – Hajde, zjarr na u baftë biseda!”<sup>15</sup>

<sup>13</sup> IAKSA, Arkivi Etnografik, Fondi: Ramadan Sokoli, Dosja: 14/6, Viti: 1950, Fl: 28.

<sup>14</sup> IAKSA, Arkivi Etnografik, Fondi: Afërdita Onuzi, Dosja: 28, 593/29, Viti: 1971, Fl: 15.

<sup>15</sup> IAKSA, Arkivi Etnografik, Fondi: Ramadan Sokoli, Dosja: 14/6, Viti: 1950, Fl: 39.

Gjenden të arkivuara shumë mbledhje terreni që përshkruajnë lidhjen e fejesës, në të cilat ky hap i parë domethënës është i ngjashëm.<sup>16</sup>

Një moment shumë i rëndësishëm, i pasur me formulësime kërkesash e përgjigjesh të sakta, ishte kur pas këtyre veprimeve gjestore hyhej në temë nga shkuesi për të kërkuar dorën e vajzës.

Mbledhësi në terren, Xhemal Berisha edhe emri, përshkruan në materialet e depozituara në arkiv për Dibrën, bashkëbisedimin ndërmjet shkuesit me babain e vajzës si më poshtë:

“A je kah ma falë atë çikë?”

“Po s’qe e shkrueme nuk muj.”

“Paj n’qoftë thanë edhe ta jap.”

“Un ta lypa si tuj qeshë, por çok se e kam përnjimend.”

“Po m’kallxo për kand e ke.”

“Për filanin. Aj të don për mik. Ne daç, edhe ti jepja çiken.”

Ai shënon se kështu ndodhte deri në mesin e shekullit XX.<sup>17</sup>

Sipas studiuesit Ukë Xhemaj në shumë vise të Kosovës, edhe për shkak të largësive të terrenit ndër zona të thella, shkuesit i shtrohej darkë, si një miku të veçantë. Ai, sipas rregullit të traditës, gati në formë formule i drejtohej mikut:

“O mik, sot t’kam ardhë n’konak, amanetçi i porositur [thuhet emri i babait të djalit], me ta bo me dije që të ka begenisë për mik dhe po ka kërkon dorën e çikës për djalë [nënkuptohet vajza që sipas rradhe ishte për fejesë, si dhe theksohet emri i djalit, pozita e tij në familje deri në atë moment].”

Pritësi i përgjigjej: “Me nder e me faqe të bardhë, së pari për atë që më zgjedh për mik e miqësi, e ma tutje si të jetë kismet.” (Xhemaj 2005, 171) I zoti i

<sup>16</sup> IAKSA, Arkivi Etnografik, Fondi: Xhemal Berisha, Dosja 19, 285/4, Viti 1964, Fleta 2.

<sup>17</sup> IAKSA, Arkivi Etnografik, Fondi: Musa Muho, Dosja: 15, Viti: 1967, Fl: 74.

shtëpisë, qoftë edhe dikush tjetër nga ai konak, duke përcjellë shkuesin deri jashtë oborrit, e shoqëronte me fjalët: “si të jenë kismet”.

Tek katolikët praktikohesh të shprehej kërkesa kur i zoti i shtëpisë ia mbushte gotën me raki shkuesit. Shkuesi ia bënte me dije në mënyrë indirekte për çfarë kishte ardhur kur thoshte: "Ne do pijmë për qejfin tonë, por as ti mos na prish qefin."

Në rast dëshire për ta shqyrtuar kërkesën, sapo ajo bëhet zyrtare me anë të mësimit, atij i thuhet nga i pari i shtëpisë: “Gja s’e ndalë ne qoftë shkruet.” (Krasniqi 1991, 159) Edhe në Has, kur kërkohej vajza, i thuhej të atit: “Të kam zgjedhë për mik.” (Çoçaj 2012, 182)

Në Dukagjin, sipas studimit të Vitore Kodrës, shkuesi, duke shpupurisë zjarrin në vatër, thoshte si formulë kërkesën: “Familja e X-it të ka mësy për mik të mirë e shtëpi të mirë e këtë punë ma ka lënë në dorë mue.” (Kodra 2013, 52)

Edhe studiuesja Sabina Vaqarri, duke përshkruar zakonet e Tiranës, nënvizon se zakonisht shkuesia fillonte si qëllim i kuptueshëm qysh në mënyrën se si paraqitej në derë të vajzës njeriu shkues. Ajo vëren se zakoni i shpuzitjes së zjarrit përshkruhet edhe në kanunet shqiptare.

“Kur shkon shkesi për herën e parë në shpin e gocës, për me e kërku, duhet doemos me shpuzit jerrmin, ndryshe nuk zen ven fjala. Prekja e zjarrit, si veprim gjestor aq i njohur, siç duket ka të bëjë me efektin që zgjon vetë kulti i tij, i përhapur ndër shqiptarë. Biseda që pritej të bëhej rrotull tij ishte si zjarri, si ngrohtësia që vjen prej tij, por puna duhej matur mirë, se zjarri edhe ngroh, edhe djeg.” (Vaqarri 2014, 56)

Ulja në vatrën e zjarrit nënkuptonte bisedën miqësore, në mirëbesim midis shkuesit dhe prindërve të djalit apo vajzës, ndërsa gjesti i ndezjes së cigares, i cili ndërpritej nga shkuesi (zakonisht mikut i ofrohet duhan nga kutia e duhanit të të zotit të shtëpisë, ndërsa në rastin e propozimit për fejesë shkuesi e “thyen” zakonin e pritjes së mikut në shtëpi dhe kjo donte të thoshte se fjala s’ishte për diçka të zakonshme, por për një gjë vërtet të rëndësishme, për krushqi, që e kishte këtë gjest si pjesë të komunikimit të rastit. “Para se të fillojmë cigaren, sillni një lugë sheqer! Duam ta fillojmë me amëlsinë, jo me thartinë, se kam ardh’ për gëzim...” Fjala ritualistike e shprehur me dikotominë *ëmbëlsirë-thartinë* shërbente për hyrjen më konkretisht në propozimin e pritshëm

për fejesë. (Po aty, 57) Edhe në disa vise të Kosovës ka veprime shoqëruese ritualistike. Sipas besimit popullor vendas, “...shkuesi, kur merrte rrugë për te miku për të kërkuar dorën e vajzës duhet të shkonte me lidhcë të këpucës zgjidhë.” (Po aty.) Ky veprim tregonte dëshirën që fejesa të mos haste në asnjë pengesë. Po ashtu nënvizohet se për mbarësi mësi nisej nga shtëpia e djalit dhe hynte në shtëpi të vajzës me këmbë të djathtë.

Në traditën shqiptare është treguar kujdes i madh nëse nuk i jepej vajza kërkuarit. Në Dibër i zoti i shtëpisë uron edhe kur nuk do t’ia japë vajzën:

“Atij i duhet të kishte kujdes, nëse nuk do të bënte miqësi me atë mik që i kish propozuar shkuesi. Megjithatë, nëse ai nuk do të jepte vajzën, e gjente një mënyrë për të mos e vrarë kërkuarin, duke i thënë shkuesit: “Hapërha nuk du me e fut në nishane. Njëqind vetë me ma kërku mas teje, nuk e ap.” (Shqefni 2011, 38)

Ose mund të thoshte edhe:

“Bani të fala filanit. Paç faqen e bardhë që më do për mik, por cucën e kam në fjalë tjetërkund. Pa e kputë me at’, sun lidhem me kërkan.” (Shqefni 2011, 38)

Në Dukagjin, kur pleqërohej për të mos u dhënë vajza, përdorej zakonisht ky formulësim që ruante respektin për burrin që kishte hyrë për të bërë krushqinë: “Për mik [mysafir] hajde sa herë të duash, se shpia asht e Zotit dhe miqve, por për këtë punë mos më hajde ma.” (Kodra 2013, 42)

Në Zadrimë, në rastet kur i zoti i shtëpisë së vajzës nuk donte ta jepte vajzën, përgjigja ishte diplomatike, e tipit: “Nuk të shaj për mik, por nuk kam terezi me e dhanë vajzën. Faqebardhë kjosh!” Kishte dhe raste që jo-ja nuk i jepej mikut herën e parë. Mund t’i thuhej: “Faqebardhë kjosh se m’ke begenis për mik, por tash po baj mendim.” Në këtë rast njerëzit e vajzës pyesnin për shtëpinë e djalit dhe për djalin vetë dhe e piquin mendimin me qetësi.<sup>18</sup>

Duke përshkruar zakonet e lidhjes martesore në Lumin e Vlorës, etnologu Musa Muho tregon se pasi merrte kërkesën, plaku i shtëpisë së vajzës kërkonte kohë. Kur, pasi pleqërohej puna dhe nuk e dëshëronte krushqinë, i thoshte shkuesit: “Për atë llafin që u mundove nuk kemi gjë.” Ky mbledhës

<sup>18</sup> IAKSA, Arkivi Etnografik, Fondi: Gjush Sheldija, Dosja: 8, 62/25, Viti: 1956, Fl: 4.

nënvizon se, në Vlorë, kur pala e vajzës nuk jepte pëlqimin për lidhje krushqie, asnjëherë nuk tregonte arsyet e vërteta, duke u përpjekur të mos fyenin kërkuessit.<sup>19</sup>

Në Rugovë nëse ndodhte që nuk iu pëlqente familja apo djali, ata, në mënyrë më të butë, mundonin të jepnin një përgjigje si: "Nuk e kem ndërmend njëherë me dhanë çikë, ka vakt.", "Çika është e re", "Çika nuk m'u ka bo për martesë."<sup>20</sup>

Në Tiranë, kur familjes së vajzës i bëhej një propozim për lidhje krushqie dhe babai i vajzës nuk donte, nuk tregonte arsyet e vërteta të mospranimit, për të mos e ofenduar familjen tjetër, por përgjigjej: "Nuk do ta fejoj tani gocën", ose: "E kam në fjalë në një vend tjetër."<sup>21</sup> Gjatë mbledhjeve në terren në vitet '50 në Mirditë, etnomuzikologu Ramadan Sokoli ka hetuar që shkuesi, kur kthehet për të marrë përgjigje, së pari, pyeste nënën e vajzës se "a ka ba mendim me gjithë burrë për kërkesën e paraqitur prej tij". Kur nuk donin t'ia japin vajzën ajo i përgjigjej: "Zoti ia çiltë fatin tjetërkund."

Pra, si përfundim, nënvizojmë mirëkuptimin, respektin reciprok që kërkohej të ruhej ndërmjet dy familjeve edhe në rast se nuk kryhej fejesa. Kjo shprehet në dialogët e mësipërm, në zgjedhjen e fjalëve, në delikatesën me të cilën shkëmbehen përshëndetjet dhe urimet dhe formulësimet e rastit.

Një fazë shumë e rëndësishme e fejesës ishte dhënia e fjalës shkuesit, mblesit, mësitit nga ana e të zotit të shtëpisë së vajzës. Ishte shumë i rëndësishëm ky hap, sepse, me anë të tij fjala kumtohej dhe jepej zyrtarisht. Marrja e këtij lajmi në familjen e djalit dhe të vajzës hapte rrugë që çdo gjë të vijonte me organizimin e hapave zyrtarë përfundimtarë për kryerjen e fejesës nga të parët e dy shtëpive.

Fjala që i jepej shkuesit për ta kryer fejesën kishte shumë peshë. Ishte shumë e njohur formula e dhënies së vajzës. Formulësimi: "Ta kam falë vajzën" përfshin në vetvete botën emocionale të prindit, si përgjegjësi i plotë i

<sup>19</sup> IAKSA, Arkivi Etnografik, Fondi: Musa Muho, Dosja: 15, Viti: 1967, Fl: 74.

<sup>20</sup> IAKSA, Arkivi Etnografik, Fondi: Gjush Sheldija, Dosja: 8, 62/25, Viti: 1956, Fl: 8.

<sup>21</sup> IAKSA, Arkivi Etnografik, Fondi: Mehdi Hoxha, Dosja: 42, Viti: 1981, Fl: 31.

jetës së mëtejshme të fëmijës së vet. Shpesh, për arsye propagandistike, kjo shprehje është trajtuar si konsiderimi i vajzës si plaçkë tregu. Por, e parë me sy njerëzorë dhe e vendosur në kohë e hapësirë, në kohën e kanuneve dhe dokeve të vjetra, mendojmë se, përtej patriarkalizmit që ngërthen në vetvete faktin se kush e merr këtë vendim, në këtë shprehje të qartë fshihet mallëngjimi, përgjegjshmëria, preokupacioni, dashuria natyrale për krijesën e tij, e cila edhe pse shumë e re, e brishtë, dihej se shumë shpejt pas këtij vendimi do ikte në shtëpi të vet e do vinte vetëm për mik. Dilema se çfarë rezervonte e ardhmja, me siguri do të ketë qenë pjesë e reflektimit emocional të thellë. Nuk harrohej kurrë thënia popullore “vajza lind në shtëpi të huaj e shkon në shtëpi të vet.” Janë shprehje që kuptimin parësor e kanë të saktë, të fshehur pas lojës së fjalëve, konform mënyrës së të menduarit, pozitës në familje, detyrave që e presin dhe shumë elemente të tjera që përbëjnë jetën rituale tradicionale. Ishte gjithashtu e njohur ngado ndër shqiptarë fjala e urtë “Një ditë o e mbyt, o e shpëton vajzën.” Përmes saj shprehet përgjegjshmëri e preokupacion që prindin e ndiqte tërë jetën, përfshirë këtu patriarkalizmin ekstrem që shoqëronte vendimmarrjen e gjithëpushtetshme të prindit.

Ashtu si bëheshin zgjedhjet e bashkëshortëve të ardhshëm, edhe djalit i ndodhte e njëjta gjë, por ai mbetej në mjedisin e tij në vijimësi, ndërmjet të vetëve, shqetësimi më i madh ishte vajza, ajo ikte. Fati i të rinjve ishte fati i një shoqërie të tërë të prapambetur, i një mënyre të caktuar të marrëdhënieve në prodhim, i një ekonomie të caktuar, i mendësive që vinin nga ai mjedis, nga ajo shkallë e zhvillimit social, ku ndodheshin shqiptarët deri në gjysmën e parë të shekullit XX.

Dhënia e dorës së vajzës nuk bëhej menjëherë. Çdo individ nuk e kishte të lehtë marrjen përsipër të këtij vendimi, sepse ai kishte të bënte me një përfshirje të madhe dhe të pazgjidhshme jo vetëm të vajzës, por të gjithë fisit. Në shumë materiale arkivore gjejmë se, i zoti i shtëpisë, ndonëse kishte të drejta absolute mbi fëmijët, nuk e priste muhabetin menjëherë, e shtynte për disa kohë. Sipas zakonit, i pyeste burrat e shtëpisë, të vëllazërisë dhe të farefisit, të cilët, të gjithë së bashku, hetonin për shtëpinë dhe për djalin.

Në Vlorë dhe në shumë zona të tjera të vendit, i pari që pyetej nga i zoti i shtëpisë ose nga prindi i vajzës, ishte daja. Kujdesi i dajës për zgjedhjen e dhëndrit ose të nuses për mbesat dhe nipat e tij ishte i madh, sepse vëllai i nënës konsiderohej farefisi mashkull më i afërm. Pasi hetohej mirë familja e

dhëndrit nga të gjithë, takoheshin me shkuesin në ditën e caktuar dhe i jepnin përgjigjen për kërkesën e bërë.

Gjatë mbledhjeve në terren në vitet '50 në Mirditë, Ramadan Sokoli ka hetuar se kur donin t'ia jepnin vajzën thuhej:

“Si ke mendue ti për vajzën teme, mendoftë i lumi për fëmijët e tu.” Të nesërmen, pasi merrnin fjalën e shkuesit, ana e djalit thërrisnin kushërininë dhe kumtonin: “Po shkojmë me i xanë një nuse djalit te filani.” Përgjigja e tyre ishte: “Me hajr e me nafakë dhe ia mrrifshi asaj dite me marrë nusen.” Sapo jepej fjala, gratë e spërkasin shtëpinë me ujë të bekuem, i vinin rrokoll kullës me një tjegull plot shpuzë e me lari, për me beku sidomos qoshet e shpisë tue thanë: “Nusja ardhtë me nafakë! Syni i keq mos e paftë!”<sup>22</sup>

Pëlqimi mund të jepej menjëherë kur mësimi ishte daja ose një i afërt tjetër i vajzës, për qëllimet e mira të të cilëve nuk dyshonin. Në raste të tilla, i ati i vajzës i drejtohej mësitit: “Ta kam falë vajzën!”, “Në dorën tëndel!” etj.

Ka disa formula urimi kur këputej puna. Këto formula kanë vlerën e tyre kuptimore, ishin kode rregulluese të raportit të ri, i cili duhej të ishte sa më i qartë, sa më i rregullt dhe mirëbesues. Përdorimi i tyre e bën shtjellimin e ngjarjes të fitojë simbolikisht karakteristikat e një mizanskene të ngjashme me ato teatrore, ku teksti dhe veprimi janë të mirëpërcaktuara dhe kumtohen shkoqur.

Në Zadrimë, nëse vendoste për ta dhënë vajzën i zoti i shtëpisë së djalit organizonte një darkë të madhe, duke thirrur dhe kushërinjtë për të pritur “po-në” e shkuesit. Daja shkonte bashkë me një burrë të shtëpisë së vajzës, por që nuk duhej të ishte i ati i vajzës. Pasi pinin kafet daja i vajzës thoshte: “Për të mirë e me hajre. N.N ta ka dhanë vajzën”. Në këtë moment gratë e shtëpisë mblidheshin dhe i këndonin këngën dajës.

Në Dibër mjaftonte t'i thuhej një “po” shkuesit dhe vajza quhej e fejuar, quhej *cuçë e forcume*. Edhe në këtë emërtim sinonim dallohet preokupacioni i prindërve për të ruajtur të papërlyer vajzën deri sa ta çonin në fatin e vet. Tanimë, pas fejesës, ajo mbrohej nga dy palë shtëpi, e saja dhe e

<sup>22</sup> IAKSA, Arkivi Etnografik, Fondi: Ramadan Sokoli, Dosja: 14/6, Viti: 1950, Fl: 39.

burrit, ndaj quhej *e forcume*. I zoti i shtëpisë së vajzës nuk mund të luante nga fjala, pasi kështu binte në gjak me familjen e djalit.

Etnografi Gjush Sheldija, nënvizon se në qytetin e Shkodrës, ku rolin e shkuesit e kryente shpesh ndonjë grua dashamirëse ose e specializuar në këto punë, e cila ia kishte bërë të ditur kërkesën nënës së vajzës qartë dhe pasi kjo kërkesë ishte shqyrtuar nga të zotët e shtëpisë, roli i grave përfundonte këtu. Nëna e vajzës thërriste shkuesen dhe i thuhej se ma mirë ishte “të flitshin trimat vetë me shoqishojnë” dhe të kryhej puna. Prej shtëpisë së vajzës ngarkohej një burrë i afërt për të folur me shkuesen. Ai, me ndërmjetësimin e saj, takohej veçmas me babën e djalit dhe kur “bijshin ne kodi”, shtroheshin konditat, thirrej babai, vëllai dhe axha apo daja i vajzës e aty jepej fjala e fejesës dhe në peng dorëzoheshin uratët e xhepit, si *shej i vogël*. Urimi i ndërsjelltë ishte: “Na qoftë për hajër! Pastë qëllue sahati i hajrit!” Caktohej edhe dita e *shejit të madh*. Aty vajza njehej *e xanun*, por jo e fejueme, deri sa sillej sheji i madh. Për këtë shej, që ishte festa përmbyllëse e fejesës, gjendej një datë në shej, për t’i dhanë edhe më tepër ceremonialitet rastit, bahej dy ditë pas Krishtlindjve ose Pashkëve, apo në një datë tjetër të shënuar.<sup>23</sup>

Ajo që vëmë re në këto përshkrime terreni është se janë shumë të ngjashme skenat e dhënies së fjalës për vajzën. Kur zhvilloheshin bisedimet dhe dukej se çështja po merrte udhë, kafja e parë zakonisht i vihej shkuesit, por sipas zakonit, ai nuk fillonte për ta pirë kafënë, derisa i bëhej përhajër fjala për vajzën. Formula ishte: “Na qoftë për hajër!” Shkuesi e kthente në të njëjtën mënyrë: “Hajr paç dhe paçi faqen e bardhë! Pritsh e martofsh nipa e mbesa! Për hajër ju qoftë miqësia të dy palëve!” Zakonisht, pas fjalës së dhënë pihej kafeja, pasi sipas zakonit ajo nënkuptonte mbylljen e një çështjeje.

Sipas etnografes Llambrini Mitrushi në Myzeqe, kur donin t’ia jepnin vajzën, i thoshin lajmësit: “Të na jetë e hajrit miqësia, të na jetë me kismet lajmësia!” (Mitrushi 1972, 180)

Në Vlorë, kur familja e dëshëronte lidhjen e krushqisë shprehej: “E biseduam, more mik, atë çështje dhe i dhamë karar, prandaj të qoftë falë.”<sup>24</sup> Në Rugovë, në familjen e vajzës, kur iu pëlqente miqësia dhe vendosnin ta

<sup>23</sup> IAKSA, Arkivi Etnografik, Fondi: Gjush Sheldija, Dosja: 8, 62/25, Viti 1956, Fl: 3.

<sup>24</sup> IAKSA, Arkivi Etnografik, Fondi: Musa Muho, Dosja: 15, Viti: 1967, Fl: 74.

jepnin vajzën thoshin: "Na kjoft për hajër miqësia!"; "Na po ta falim këtë vajzë e sido që të dalë puna, ty të njohim mirë, o lumë mikul!"; "Paska kenë kismet e na kjoft për hajër të dy palëve!"; "Na e ka falë Zoti e po ta falim edhe na!"; "Po ta falim këtë çikë e na paç në qafë n'kofsh me hile!" e shprehje të tjera të kësaj natyre.

Në Tropojë, sipas mbledhësit Myftar Memia, i kthehej kjo përgjigje mësiti kur i kërkohet dora e vajzës: "Paç faqen e bardhë, se bash si burrat ia ke ba, se na çikat për miq i kem e mik ma t'mirë nuk kishim mujtë me gjetë. I pafshin hajrin çikës! Për hajër na qoftë miqësia! Në amëlcim shkoftë miqësia të dy palëve!" Përgjigja: "Hajër paçi e u lumtë goja!"

Sipas tij, menjëherë mësiti shkonte në shtëpinë e djalit me ia ba për hajër, duke çuar dorën e çikës.<sup>25</sup>

Fjala e dhënë konsiderohej punë e mbaruar dhe mësiti, me marrjen e fjalës pohuese, shkonte për të lajmëruar familjen e djalit për fjalën e nuses. Pritja nga familja ishte me nderime e gosti, aty shkonin gjithë familja e barkut dhe farefisi për ta pritur mësitarin.

Në gjuhën zakonore të krahinave shqiptare sjellja e dorës së vajzës nga ana e shkuarit quhej "sjellje e dorës", "maramës", "sjellja e fjalës", "sjellja e dorës së nuses", "fjalënusja", "dorënusnia" (Dibra 2016b, 33). Me këtë rast urohej me gëzim e me mallëngjim në të dy palët:

“- Për hajër!

- Si të jetë e shkruar prej Zotit! Paska qenë e shkruar kështu, për hajër!

- Miqësia na qoftë për hajr, paçin faqen e bardhë!

- Për hajër fjala e fejesës!

- Kjoft përhajr ëmnimi e kjoshi jetgjatë e u trashigoshi!

- E gëzofsh nusen e u plakshi bashkë! Për të mirë e me hajër, N.N ta ka dhënë vajzën.” (Dibra 2016b, 33)

Prindërit e dy fëmijëve uroheshin kështu prej të pranishmëve: “Ja mbërrifshi edhe më të voglit!” Ngado në përshkrimet e fejesave nënvizohen urimet për

<sup>25</sup> IAKSA, Arkivi Etnografik, Fondi: Myftar Memia, Dosja: 84, Viti: 1971, Fl: 50.

shkuesin të natyrës: “T”lumshin kambët, ore mësiti, ishalla nuk e harron zanatin edhe për hera tjera e këtë të mirë ta kthefshim për të mirë! T’u shtoftë hisja, t’u gzoftë shtati, ju gzoftë zemra! Mësitit tonë ju gëzoftë zemra, iu gëzoftë goja, iu gëzoftë hisja!” (Çoçaj 2012,105)

Ishte zakon që pasi e mbaronte punën e tij, shkuesi shpërblehej me këngë e me dhurata, të cilat dallohen të jenë të ndryshme në zona të ndryshme. Shpesh organizohej një ceremoni për nder të tij kur sillte fjalën dhe aty i jepeshin dhurata. Në Lumë, kjo gosti quhej “bukë me lekë”. Këndohej e kërcëhej këngë për shkuesin nga folklori i zonës.

Ka në të gjitha krahinat tona një cikël të posaçëm këngësh për shkuesin, të cilat këndohen kur ai sjell dorën e nuses.

-More shkues mos t’a harrofsha,/ n’darsëm të djalit ta pagjofsha./  
More shkues me mitan/ Çashtu njefsha n’gjalin tand.

-N’e paç ba nusen e keqe/ t’u baft’ udha lak e leqe.<sup>26</sup>

Kemi nënvizuar se shumë shpesh në traditën tonë daja ishte personazh kryesor në shkëmbimin e negociatave dhe në sjelljen e përgjigjes. Në këto këngë gjen edhe urime për dajën: “Ti na paç faqen e bardh’, mor daja!”

Urimet e përdorura si formulësime në momentin kur i jepej fjala shkuesit shfaqin dashurinë dhe aspiratat për jetën, shprehin raportet e afërta miqësore sipas rendit e farefisnisë, krushqisë e kumbarisë, miqësisë e shoqërisë, shprehin njohjen e saktë të detyrimeve për njëri-tjetrin, të aspiratave për jetë të qetë e të sigurtë bashkëshortore të dy të rinjve dhe për atë çka dëshironte dhe priste fisi nga kjo lidhje martesore.

Natyrisht studimet mbi këto formulësime, urime, përshëndetje standarde, njëherësh funksionale në momentin kur këputej puna për fejesë, do të mund të thelloheshin edhe me njohjen e tyre në krahina të tjera shqiptare, për të cilat gjenden mjaft studime dhe mbledhje terreni të arkivuara në institucionet e specializuara. Gjithashtu, do të mund të thellohej edhe më tej

---

<sup>26</sup> IAKSA, Arkivi Etnografik, Fondi: Afërdita Onuzi, Dosja: 28, 593/29, Viti: 1971, Fl. 16.

njohja dhe kuptimi polosemantik i tyre, nëse i drejtohem analizave stilistikore të vetë shprehjeve si të tilla, ose kur ato dallohen si pjesë e inkorporuar në vargje të teksteve të këngëve rituale. Shumë interesante dhe me interes do të ishte përshkrimi i gjendjes aktuale aplikative të kësaj mënyre të kodifikuar të foluri në vendet ku jetojnë shqiptarët, për faktin se ndryshimet në mënyrën e jetesës, në botëkuptim dhe sjellje kanë ndryshuar shumë për arsye objektive dhe subjektive. Por, studime të tilla, mund të jenë pjesë e punimeve më të gjata mbi këtë argument dhe kjo i takon thellimit të mëtejshëm të autores në studimin e ritualit të dasmës.

### Bibliografi

- Berisha, Kolë. 2013. *Përreth sofrave*. Lezhë: Gjergj Fishta.
- Bardhoshi, Nebi. 2015. *Antropologji e Kanunit*. Tiranë: Pika pa sipërfaqe.
- Brisku, Bahri. 2012. *Këngë popullore të shqiptarëve në Mal të Zi*. Ulqin: Rozafa.
- Çapaliku, Alfred, Miaser Dibra dhe Shpresa Rama. 2006. *Paralele folklorike ndërkuftare*.
- Shkodër: Camaj-Pipa.
- Çaushi, Abedin. 1974. "Martesa në qytetin e Elbasanit". *Etnografia shqiptare* 5: 231- 256.
- Çoçaj, Nexhat. 2012. *Hasi. Enciklopedi etnokulturore* IV. Durrës: Pavarësia.
- Dibra, Miaser. 2017. *Këngë dasme, Antologji*. Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike.
- Dibra, Miaser. 2016a. "Disa aspekte të psikologjisë popullore për fejesën tradicionale ndër shqiptarë, pasqyruar në krijimtarinë gojore". *Gjurmime albanologjike* 46: 90 – 112.
- Dibra, Miaser. 2016b. "Fjalënjësja në krijimtarinë gojore tradicionale." *Kultura popullore* 1-2: 47 – 77.
- Dibra, Miaser. 2004. *Ceremoniali i dasmës në qytetin e Shkodrës*. Tiranë: Akademia e Shkencave.
- Doçi, Pal. 1996. *Vetëqeverisja e Mirditës*, Tiranë: Botime Enciklopedike.
- Dojaka, Abaz. 1983. *Dasma në Shqipëri*, Tiranë: 8 Nëntori.
- Durham Edith. 1998. *Brenga e Ballkanit*. Tiranë: Argeta-LMG.
- Elezi, Ismet. 2002. *E drejta zakonore e Labërisë*. Tiranë: Toena.
- Elezi, Ismet. 2006. *Kanuni i Labërisë*, Tiranë: Toena.
- Fetahu, Petrit. 2003. *Studime folklorike dibrane*. Dibër e Madhe: Dibra.

- Halili, Lindita. 2012. *Ceremoniali i dasmës lumjane*. Shkodër: Fiorentina.
- Hasluck, Margaret. 2005. *Kanuni-Ligji i pashkruar shqiptar*. Lezhë: Lisitan.
- Ilia, Frano. 1993. *Kanuni i Skënderbent*. Milot: Rosa.
- Çetta, Anton, përg. *Këngë dasme*. 1980. Prishtinë: Instituti Albanologjik.
- Krasniqi, Mark. 1991. *Nga gurra e traditës*. Prishtinë: Zëri.
- Krasniqi, Mark, përg. 1987. *Rugova: monografi etnografike*. Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës.
- Kodra, Vitore. 2013. *Dasma në Dukagjin*. Shkodër: Camaj-Pipa.
- Kujxhia, Gjon. 1943. *Valle Kombëtare, Dasmë Shkodrane*. Firenze: Il cenacolo.
- Lirika Popullore* 4, 1990. Tiranë: Akademia e Shkencave.
- Memia, Myftar. 1962. “Dasma në Malësinë e Gjakovës”. *Etnografia shqiptare* 1: 276-307.
- Mitrushi, Llambrini. 1972. “Dasma në lalët e Myzeqesë” *Etnografia shqiptare* 4: 175-217.
- Shkurtaj, Gjovalin. 2010. *Etnografia e të folurit të shqipes*. Tiranë: Morava.
- Shqefni, Mimoza. 2011. *Dasma tradicionale dibrane*. Tiranë: Geer.
- Tirta, Mark. 2003. *Etnologjia e shqiptarëve*. Tiranë: Geer.
- Uçi, Alfred. 1989. *Estetika*. Tiranë: SHBLU.
- Vaqarri, Sabina. 2014. *Rite e zakone të dasmës tradicionale tiranase*, Tiranë: Iceberg.
- Xhagolli, Agron, Miaser Dibra, Afërdita Onuzi, Albana Velianj, Shefqet Hoxha, Shaban Sinani, Ariana Seiti, Jaho Brahaj. 2010. *Klasifikimi dhe digjitalizimi i prozës dhe poezisë popullore shqiptare*. Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjike.